



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 62 datë 26.11.2020

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË PROJEKTIT
“UNË JAM NGJYRA”

Këshilli i Bashkisë Skrapar, në mbledhjen e datës 26.11.2020, mori në shqyrtim projektaktin me titull “Unë jam ngjyra”, i cili ka për qëllim nxitje e përfshirjes përmes formave shprehëse të edukimit të fëmijëve nga 2-6 vjeç, të cilët rriten në kushtet e shtëpisë në zonat rurale, si fillim këshilli kërkon që ky projekt të zbatohet në fshatra Osojë, Slatinjë, Rovicë, Veleshnje, Grepckë, ku projekti do të targetojë 30 përfitues fëmijë të moshës 2 – 6 vjeç të cilët për shkak se nuk kanë kopshte, pasi numrat nuk mundësojnë krijimin e grupeve, në këto fshatra.

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit prej 150 000 lek për zbatimin e projektit “Unë Jam Ngjyra”, për periudhën Janar- Prill 2021, i cili synon përfshirjen e fëmijëve përmes formave shprehëse të edukimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 10 vota pro , vota kundër - 1 , vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

